

Mbi
Auditimin e Brendshëm
Ushtruar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Ndjekjes Investimeve të Infrastrukturës,
Sektori i Shërbimeve Mirëmbajtjes Varreza
-Bashkia Shkodër

Njësia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkodër bazuar të nenin 4 të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, planit vjetor të auditimit të brendshëm, zhvilloi një mision auditimi të plotë lidhur me veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Ndjekjes Investimeve të Infrastrukturës, Sektori i Shërbimeve Mirëmbajtje Varreza- Bashkia Shkodër për periudhën 30 Qershor 2013 deri 30 Qershor 2018 dhe nga auditimi i kryer rezultoi:

Përmbledhje ekzekutive

Në drejtorinë e Shërbimeve Publike Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës, Sektori i Mirëmbajtjes Varrezave gjatë auditimit janë konstatuar mangësi në kontratën themelore, ku nuk ka të përcaktuar kushte të vecanta, specifikimet teknike të shërbimeve, vendndodhjen, nuk ka të përcaktuar sipërfaqen për mirëmbajtje, nuk ka të bashkangjitur planimetri - projekt , si dhe nuk ka grafik analitik të kryerjes së punimeve. Kontrata themelore nuk ka të bashkangjitur licencat e kontraktuesit sipas ligjit për kryerjen e shërbimit mirëmbajtjes varrezave publike dhe dëshmorëve. Në kontratën themelore nuk ka të bashkangjitur liçensën e operatorit ekonomik fitues dhe liçensën e supervizorit që kryejnë dhe mbikqyrin shërbimin e mirëmbajtjes varrezave.

Ndërsa në Aneks kontratë mungojnë : specifikimet, preventivat analitik që kanë të bëjnë me analizë të proceseve të punës, të llogaritjes së punëtorisë, të llojeve të materialeve, të llogaritjes së punimeve të mbjelljeve bordure të gjelberta, drurëve dekorativ, numrit rojeve private, punimeve në mirëmbajtjen varreza të dëshmorëve, si dhe mungojnë planimetria, grafiku vjetor i punimeve. **Mbikëqyrja e punimeve** është kryer nga person juridik i paisur me liçensën përkatëse (sipas kqyrjes në QKR).

Përgjegjësi, specialisti i drejtorisë Shërbimeve Publike ka preventivuar punën e shërbimit të mirëmbajtjes varreza (pa specifikime, pa planimetri, pa grafik). Punimet dhe shërbimi janë mbikqyruar nga supervizori, i cili për punën e kryer ka mbajtur akt kontrolli, ka informuar drejtorinë shërbimeve me relacione , punët dhe problemet nuk përshkruhen në cilësi dhe sasi.

Mbikqyrësi mban proces verbale dhe përpilon situacionet për punët e kryera. i gjithë dokumentacioni dhe procedura e punës së supervizorit dhe specialistit (preventivuesit) të drejtorisë Shërbimeve Publike nuk protokollohet. Nuk është kryer raportimi i shërbimit nga drejtoria e Shërbimeve Publike drejtuar Kryetarit të Bashkisë.

Gjetje

1-Auditimi i kontratës themelore, lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër dhe sipërmarrësit.

Gjetje nr 01 Kontrata themelore nuk ka të përcaktuar tek kushtet e vecanta, specifikimet teknike të shërbimeve, vendndodhjen, nuk ka të përcaktuar sipërfaqen për mirëmbajtje, nuk ka të bashkëlidhur as planimetri as projekt , si dhe nuk ka grafik të detajuar të kryerjes së punimeve.

Gjetje nr 02 Kontrata nuk ka të bashkangjitur licensat e kontraktuesit sipas ligjit për kryerjen e shërbimit mirëmbajtjes varrezave publike dhe dëshmorëve.

Gjetje nr 03 Preventivi përmbledhës në tre zëra: 1-roje, 2-mirëmbajtje varreza 3-mirëmbajtje varreza, vendosje germa e pllaka mermeri 1.3% nuk ka të përcaktuar elementin “sasi”. Nga auditimi i dokumentit të preventivit rezultoi që preventivuesi nuk ka përcaktuar elementin “sasi” në tre zëra të preventivit ,të lartëpërmendur.

2-Likuidimi i detyrimeve kontraktore

Gjetje nr 04 : Referuar nenit 33 të ligjit “Për prokurimet Publike” pika 5, germa “a”, i ”Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit”, si dhe referuar nenit 28 “Ndryshimi i porosisë” i Kontratës Themelore datë 01.07.2013 drejtorja Shërbimeve Publike duhej të zbatonte rregullat e prokurimit publike”. Nga auditimi rezultoi që mes Bashkisë Shkodër dhe operatorit ekonomik “Vllaznimi” shpk është lidhur “Shtesë Kontratë” date 27.04.2015 me objekt “Mirëmbajtje varreza publike dhe dëshmorëve” , me vleftë 891.928 lek (me tvsh), për zerat “mirëmbajtje parcela” e shtuar parcela me 4312m2 dhe roje per 360 me ndryshim cmimi per 1283.7 lekë, për të cilën nuk është kryer procedura e prokurimit publik “negocim pa shpallje paraprake njoftimi”.

Gjetje nr 05 Në doje mungon një preventiv i muajve Mars –Prill, mungesa e preventivit nuk lejon të bëjmë auditimin e zërave të preventivit me situacionin dhe me kontratën.

Gjetje nr 06 Nga krahasimi i vleftave të preventivuara me vleftat e situacionuara (sipas tabelës) për vitin 2016 rezulton një diferencë prej 600.496 lek e preventivuar me tepër se vlefta e situacionuar. Nga auditimi rezulton se kjo vleftë i perket periudhës Maj 2016 është llogaritur dy herë në tabelë. Vlefta nuk përbën dëm ekonomik për arsye se është vënë gabim në tabelë por nuk është likuiduar.

Gjetje nr 07 Nga krahasimi i vleftës së aneks kontratës me vleftën e situacionit për muajin janar rezulton një diferencë prej 117.937 lekë situacionuar më shumë se vlefta aneks kontratës, por është likuiduar më pak se situacioni ,me vleftën 482.554

Gjetje nr 08 Në një pjesë të aneks kontratave mungojnë preventivët. Nga auditimi i dokumentit të preventivit rezultoi që për muajin janar 2018 nuk është bërë preventivim i shërbimit të varrezave. Nga auditimi në disa raste aneks kontratat nuk kanë të bashkëngjitur preventivin , rastet janë të shënuara sipas viteve e periudhave në projekt raport.

3-Dokumentacioni i perpiluar nga mbikqyrësi

Gjetje nr 09 Dokumentacioni i perpiluar nga supervizori, relacionet mujore dhe akt-kontrollet nuk përmbajnë përshkrim të proceseve dhe të shërbimit të vlerësuar nga ana sasiore e cilësore. Nuk mbahen evidenca. Dokumentacioni nuk është i protokulluar.

Gjetje nr 10 Nuk është bërë arkivimi i dokumentacionit për shërbimin e mirëmbajtjes varreza.

Gjetje nr 11 Në dosjen personale të supervizorit mungon përshkrimi i punës dhe licenca e lëshuar nga QKL

4-Monitorimi i shërbimit

Gjetje nr 12 Referuar nenit 40 të “kontratës themelore” Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk dokumenton monitorimin e kontratës , si dhe nuk informon me shkrim rregullisht Kryetaren e Bashkisë në lidhje me shërbimin e mirëmbajtjes së varrimit.

5-Vlerësimi i Kontrollit të Brendshëm

Spektori i Planifikimit e Mirëmbajtjes së Varrezave, duhej të kishte ndjekur ecurinë e punës së operatorit ekonomik dhe mbikqyrësit të punimeve si dhe të njoftonte me shkrim drejtorin e Shërbimeve Publike dhe ky i fundit Kryetaren e Bashkisë lidhur me kryerjen e shërbimit në mirëmbajtjen e Varrezave Publike dhe të Dëshmorëve.

Rekomandime:

Rekomandimi nr. 1 Të përpilohen preventive analitik vjetor.

Rekomandimi nr. 2 Të përpilohet grafiku vjetor dhe mujore (sipas rastit).

Rekomandimi nr. 3 Mbikqyrja e shërbimit të kryhet nga persona fizik e juridik të licensuar nga QKL.

Rekomandimi nr. 4 Mbikqyrja, monitorimi dhe raportimi të kryhet rregullisht, të dokumentohet kryerja e shërbimit për cdo zë në sasi e cilësi ,nëpërmjetë protokollit.

Rekomandimi nr. 5 Situacioni total mujore të jëtë deri në kufirin e shpenzimit vjetor të kontratës.

Rekomandimi nr. 6 Të përgatitet përshkrimi i punës për supervizorin nga Drejtoria shërbimeve Publike dhe drejtoria Përsonelet të Bashkisë.

Rekomandimi nr. 7 Për cdo ndryshim në kontratën themelore të bashkëpunohet me drejtorinë Juridike, Prokurimeve e Publike dhe Financës.

**Njësia Auditimit Brendshëm
Bashkia SHKODËR**